

BASHKIA TIRANË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Ergi” shpk & “2T” shpk,
Lagja Nr. 1, pallati Metalurgu, hyrja Nr. 1, Kukës.

Procedura e prokurimit: Loti VII “Riforcim i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Tiranë”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-92420-04-07-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1; Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Neni 41.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

1. Operatori ekonomik “Agri Construction” shpk, NUIS K01725001F
2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Ergi” shpk & “2T” shpk, NUIS K71412003A & NUIS K02727229P & NUIS K01731001M
3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Egeu Stone” shpk & “Alb Tiefbau” shpk NUIS L63916002I & NUIS J66703049C
4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Euro-Alb” shpk & “Sireta 2F” shpk, NUIS K66613407H & NUIS K51501008J
5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Igroup” shpk & “Inerti” shpk, NUIS M01406012K & NUIS K21622001M
6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk & “Everest” shpk, NUIS K51712017A & NUIS J78311921L
7. Operatori ekonomik “Llazo” shpk, NUIS K24218401K
8. Operatori ekonomik “PE-VLA-KU” shpk, NUIS K61716013M

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Ergi” shpk & “2T” shpk, NUIS K71412003A & NUIS K02727229P & NUIS K01731001M

Oferta ekonomike = 110,697,492.28 (njëqind e dhjetë million e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy pikë njëzetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “PE-VLA-KU” shpk, NUIS K61716013M

Oferta ekonomike = 110,700,000 (njëqind e dhjetë milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

2. Operatori ekonomik “PE-VLA-KU” shpk

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ofertat e paraqitura nga operatorët e mësipërm ekonomikë janë identifikuar si oferta të pasuksesshme pasi referuar pikëzimit nuk arrijnë pikët maksimale.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Ergi” shpk & “2T” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 26 / 07/ 2021

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.